

TERMAT E REFERENCËS

GARA PËR PËRZGJEDHJEN E ESESË MË TË MIRË:

ÇKA ËSHTË KORRUPSIONI?

Kush mund të garojë:	Nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Prishtinës
Afati:	6 nëntor- 20 nëntor, 2015 (2 javë)
Çmimi:	Instalimi i Këndit të Anti-Korrupsionit në tre Shkollat Fituese

Rreth Projektit të UNDP-së, në Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korrupsion në Kosovë

Projekti për Mbështetje Përpjekjeve Anti-Korrupsion në Kosovë, në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Zyra në Kosovë, falë donacionit të Zyrës Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, mbështet kapacitetet e institucioneve të Kosovës, për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Ndër partnerët kryesorë të Projektit janë: Agjencia e Kosovës Anti-Korrupsion, Gjykatat dhe Prokuroritë, si dhe komunat dhe shoqëria civile.

Gjatë vitit 2015, Projekti ka realizuar një sërë ligjëratash për nxënës të shkollave të mesme të Komunës së Prishtinës, ku përfaqësues të institucioneve si dhe ekspertë të fushës, kanë diskutuar me nxënësit lidhur me temën e korrupsionit.

Gara për përzgjedhjen e esesë më të mirë

Duke pasur parasysh që rinia luan një rol mjaft të rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit, posaçërisht me ofrimin e njohurive lidhur me atë se çka është korrupsionit, projekti SAEK i UNDP-së, në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim të Komunës së Prishtinës, shpall të hapur garën për përzgjedhjen e esesë më të mirë në temën: “Çka është korrupsioni?”

Eseja ka për qëllim të inkurajojë nxënësit e shkollave të mesme të shprehin përmes esesë, perceptimin e tyre mbi korrupsionin.

Procesi i Vlerësimit

Secila shkollë konkurruese do të themelojë një komision vlerësues të arsimtarëve, që do të vlerësojë pastaj esetë konkurruese të nxënësve të saj. Në fund, ky komision do të përzgjedh tre esetë më të mira, për konkurrim të mëtutjeshëm për garën për esenë më të mirë, në nivel të shkollave të Komunës.

Pas përfundimit të afatit, një komision me përfaqësues të Komunës së Prishtinës, UNDP-së dhe Qendrës së Kosovës për Arsim do të vlerësojë esetë e shkollave konkurruese, për të përzgjedhur pastaj tre esetë më të mira.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të mbahet në javën e parë të dhjetorit. Menjëherë pas ceremonisë së ndarjes së çmimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës dhe

menaxhmentin e shkollave fituese, Projekti i UNDP-së do të nis punët rreth realizimit të këndit anti-korrupsion.

Çmimi: Këndi Anti-Korrupsion

Çmimi për esenë më të mirë do t'i ndahet shkollës në të cilën vijon mësimet nxënësja/nxënësi që ka konkurruar me ese. Gjithsej, janë tre çmime për tre shkolla fituese, në kuadër të Komunës së Prishtinës.

Çmimi përmban instalimin e këndit të anti-korrupsionit në shkollën fituese, me elementet si vijon:

- Kompjuter;
- Raft librash me material anti-korrupsion (në gjuhën shqipe dhe angleze);
- Tavolinë dhe karrige;
- Materiale promovuese

Këndi anti-korrupsion do të ketë edhe kutinë e ankesave lidhur me sjelljet e pahijshme eventuale të stafit mësimdhënës, rastet e dyshuar për nepotizëm, kushtëzim të notave, etj.

Kushtet e Konkurrimit

Nxënësit duhet të hartojnë esetë dhe të njëjtat t'i dorëzojnë te panelet e shkollave përkatëse. Pas vlerësimit fillestar nga këto panele, esetë do të dorëzohen deri në afatin e caktuar, pranë Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës.

Eseu të dorëzohet sipas kushteve më poshtë:

- Të ketë jo më pak se një faqe, dhe më së shumti dy faqe në tërësi;
- Formati: A4; fonti: Times New Roman; madhësia 12;
- Pranohen edhe esetë e shkruara me dorë;
- Eseu të përmbajë strukturë, si: hyrje, pjesën kryesore dhe përfundimin;
- Gjuha e konkurrimit është gjuha shqipe.

Afati i Konkurrimit

10 nëntor- 24 nëntor, 2015